

Data 30/11/2022

PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS - SHËRBIME

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “STUDIMI I MENAXHIMIT TË EMERGJENCAVE DHE KONTROLLIT TË SIGURISË SË DIGAVE”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
98300000-6 – shërbime të ndryshme.

VLERA E FONDIT LIMIT: 10,000,000 (Dhjetë milion) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor **Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 5;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 12.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas Shtojcës 12.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedures është "Shërbim Konsulence", përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 2, gërma "c" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku përcaktohet se: " 40% të vlerës së parashikuar të kontratës në procedurat e prokurimit.... dhe ne procedurat e prokurimit "Shërbim Konsulence" si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar,

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 1 " të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku përcaktohet se: "Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklarave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare".

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 10 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a)** *Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat ISO ose ekuivalentet e tyre, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- a) ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”;
- b) ISO 45001:2018 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”;
- c) ISO 20000-1:2018 “Sistemi i Menaxhimit të shërbimit”;
- d) ISO 27001:2013 “Sistemi i menaxhimit të sigurisë informatike”;

Në rastet e Bashkimit të Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizojë sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” - Ky standard është i nevojshëm për certifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse shërbimet e ofruar janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve.

ISO 45001:2018 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”- Ky standart është i nevojshëm për ndërgjegjësimin e gjithë personelit të shoqërisë në lidhje me masat e mbrojtjes së shëndetit, sigurisë dhe konsultimit të punësuarve për vlerësimin e rrisqeve të shëndetit dhe sigurisë në punë.

ISO 20000-1:2018 “Sistemi i Menaxhimit të shërbimit” – Ky standard është i nevojshëm për të specifikuar kërkesat për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të një sistemi të menaxhimit të shërbimit. Ky sistem mbështet menaxhimin e ciklit jetësor të shërbimit, duke përfshirë planifikimin, projektimin, tranzicionin, shpërndarjen dhe përmirësimin e

shërbimeve, të cilat përmbushin kërkesat e dakorduara dhe japin vlerë për konsumatorët, përdoruesit dhe organizatën që ofron shërbime. Ky standard u jep kompanive mundësinë të demonstrojnë aftësitë profesionale të tyre në zbatimin e projekteve të teknologjisë së informacionit.

ISO 27001:2013 “Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit” – Ky standard është i nevojshëm për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të një sistemi të menaxhimit të sigurisë së informacionit. Ky standard përfshinë kërkesat për vlerësimin dhe trajtimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit të përshtatura për nevojat e organizatës, me qëllim që informacioni të mbetet i sigurtë dhe të mos çenohet siguria e sistemeve të saj nga sulmet kibernetike.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”. Çertifikatat e cilësisë janë bazuar në përputhje me objektin e shërbimit që do prokurohet.

2.3.3 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 10 (dhjetë) punonjës, për periudhën Shtator 2022 – Tetor 2022, punonjës nga të cilët:

- a) Të paktën 1 (një) punonjës, të pajsiur me certifikatë për menaxhim projektesh PMP ose ekuivalentin e tij;
- b) Të paktën 1 (një) punonjës, të pajsiur me certifikatë ITIL (certifikatë për menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë dhe IT) ose ekuivalentin e tij;
- c) Të paktën 1 (një) inxhinier elektronik;
- d) Të paktën 1 (një) inxhinier telekomunikacioni;
- e) Të paktën 1 (një) inxhinier elektrik;
- f) Të paktën 1 (një) specialist TIK;
- g) Të paktën 1 (një) punonjës, të pajsiur me Licencë në projektim në kategorinë 4-J “Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, internetit, TV, akses kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj...për objekte civile dhe industriale”.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklarimit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë

pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklarimit si:

- + Kontratë pune të vlefshme;
- + Çertifikatat e mësipërme të vlefshme,
- + Diploma;
- + Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për të paktën Shtator 2022 - Tetor 2022.

Shënim: Për efekt të vlerësimit me pikë operatorët mund të ngarkojnë në fazën e parë ose të dytë dokumentacionin e kërkuar lidhur me pikën e mësipërme.

****Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.***

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. KESH sh.a, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

Kriteri i mësipërm lidhet ngushtësisht me Specifikimet teknike për objektin e kërkuar. AK duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar i cili ti përgjigjet më së miri nevojave të kërkuara në këtë procedure.

Konkretisht:

+ 1 (një) punonjës, të pajsiur me çertifikatë për menaxhim projektesh PMP ose ekuivalentin e tij- është kërkuar kjo për të siguruar mbarëvajtjen e kontratës nga aspekti i menaxhimit të projektit me cilësi, në përputhje me standartet dhe bazuar në metodologji botërore, operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij një punonjës të certifikuar në fushën e menaxhimit të projekteve. Kjo për të siguruar Autoritetin Kontraktor se stafi menaxherial i Operatorit Ekonomik është i certifikuar, ka njohuritë dhe ekspertizën e duhur profesionale për menaxhimin e kontratës objekt prokurimi.

+ 1 (një) punonjës, të pajsiur me çertifikatë ITIL (çertifikatë për menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë dhe IT) ose ekuivalentin e tij - është kërkuar pasi çertifikimi ITIL do i shërbejë autoritetit kontraktor të verifikojë që kompania apo punonjësi i cili do të kryejë studimin është në gjendje të menaxhojë riskun, rrisë produktivitetin, parashikojë ulje kostosh dhe burimesh duke ofruar shërbim cilësor si dhe ti ndërlihdë këto sisteme me infrastrukturën IT. Është një certifikim i përdorur globalisht për projekte që përshijnë sisteme të IT si dhe bazohen në kornizat kryesore si ISO 20000, six sigma, cobit etj.

- ✚ 1 (një) inxhinier elektronik - është kërkuar pasi studimi për inspektimin e sigurisë fizikë në perimetër duhet të zhvillohet nga inxhinierë me eksperiencë të fushës dhe me njohuri bazë të elektronikës, pasi sistemet që përdoren kryesisht për sigurinë perimetrale janë sisteme elektro-mekanike në ndërthurje me sisteme software.
- ✚ 1 (një) inxhinier telekomunikacioni - është kërkuar pasi studimi duhet të përfshijë të gjithë fragmentet e sigurisë perimetrale që nga akses kontrolli e deri tek ndërlidhja midis pikave të vrojtimit. Nevoja për komunikim dhe eksperiencë e inxhinierit do të ndihmojë në parashikimet e komunikimit midis paisjeve apo vlerësimin e situatës aktuale në vend-ndodhje.
- ✚ 1 (një) inxhinier elektrik - është kërkuar pasi referuar specifikimeve teknike eksperiencë e një inxhinieri elektronik për vlerësimin e situatës aktuale të sistemit të videomonitorimit është e domosdoshme. Punimi në terren në kushte të vështira dhe me rryma të cilat përbëjnë rrezikshmëri kërkon përvojë dhe përkujdesje.
- ✚ 1 (një) specialist TIK - është kërkuar pasi studimi për sigurinë duhet të përfshijë integritet në sistemet ekzistuese TIK që KESH sh.a, aktualisht disponon. Integriteti në këto sisteme kërkon njohuri në fushën e informatikës pasi kompleksiteti është i lartë dhe sistemet janë të ndërfaqeve të ndryshme.
- ✚ 1 (një) punonjës, të pajisur me Licencë në projektim në kategorinë 4-J “Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, internetit, TV, akses kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj...për objekte civile dhe industriale” - është kërkuar pasi punonjësi i pajisur me Licencë për sistemet vërteton aftësinë për të zhvilluar një projekt që ka të bëjë me sigurinë, sistemin e akses-kontrollit, vëzhgimit me kamera etj.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Njësia e Prokurimit